



Npi – 01/209 datë: 29.09.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, diskutoi për Propozim-Vendimin e Zyrës së Kryetarit Nr.02/477, datë: 22.09.2020, dhe duke u bazuar në nenin 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; Nenin 6 paragrafi 1.2, neni 8 paragrafi 1.2 dhe neni 14 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, neni 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Kuvendi i Komunës së Shtimes, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PRONAVE TË PA LUAJTSHME TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 29.09.2020, me shumicën e votave aprovoi, vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, për 30 vite, pronën e paluajtshme Komunale:

1. Pjesë nga Prona e pa luajtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Kodra e Mustabashit”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00230-0; Me sipërfaqe 35231m²; Zona Kadastrale – Dugë; Kultura – Kullosë e klasit të 5; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 30 vite.
2. Prona e paluajtshme e Komunës te Vendi i quajtur “Ahishta për mbi shpi”, Ngastra Kadastrale: Nr. P-72809029-00251-0; Me sipërfaqe 3859m²; Zona Kadastrale – Dugë; Kultura – Kullosë e klasit të 5; Evidentuar, Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 30 vite, (tridhjetë vite).

II

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e planeve komunale si: Realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Përkrahjen e bizneseve vendore. Do të ndikojë pozitivisht në: Punësim, Investime, Shtimin e numrit të bizneseve, Rritje e numrit të taksapaguesve, Zhvillim ekonomik, dhe të hyra për Komunën.

III

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur publike (konkursit).

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim. dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj